

KALLËZIM PENAL

DREJTUAR:

PROKURORISË PRANË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Kallëzues: Bujar Sheshi, i biri i Ramiz dhe i Myzejen i dtl 15.12.1957, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga.....

E Kallëzuar: Gentiana Sula me detyrë Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit(AIDSSH), për veprën penale të “ Falsifikimit të dokumentave” të kryer nga personi që ka për detyrë lëshimin e tyre si dhe veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal

Baza Ligjore: Neni 281 e vijues i Kodit te Procedures Penale.

Unë Bujar Sheshi, Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë pasi u njoha me vendimin nr.12 datë 22.01.2019, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit(AIDSSH), paraqes Kallzimin tim si më poshtë vijon ndaj Kryetares se këtij Institucioni, si dhe çdo anëtar i tjetër të këtij institucioni që ka bashkëpunuar me të :

Me vendimin nr.12 datë 22.01.2019, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit(AIDSSH) ka vendosur:

1. *Të informojë Prokurorin e Përgjithshme, për informacionin që kërkohet me shkresën me nr.2373 datë 26.10.2018, në kuadër të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të z. Bujar Sheshi, anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë:*
 - a) *Z. Bujar Sheshi në kuptim të nenit 3 pika 4 dhe nenit 29 pika 2 gërma c) të ligjit 45 të vitit 2015 . “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, figuron në dokumentat e Sigurimit të shtetit si bashkëpunëtor, seksioni V, drejtimi Inteligjencë-Rini, por nga verifikimet e deri tanishme, nuk disponojmë dokumenta që të vërtetojnë aktivitetin e tij;*
 - b) *Z. Bujar Sheshi në kuptim të nenit 29 pika 2 gërma c) të ligjit 45 të vitit 2015 . “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, figuron të ketë materiale në emër të tij, si anëtar, në dokumentat e sigurimit të shtetit, me detyrë hetues, në sektorin e Hetuesisë në Degën e Punëve të Brëndëshme të Fierit, që nga viti 1979.*
2. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

Të dyja konkluzionet e parashtruara në pjesën e dispozitivit të këtij vendimi janë të rreme, në kundërshtim të hapur me faktet e parashtruara edhe në vetë pjesën përshkruese të vendimit, në kundërshtim të hapur me ligjin 45/2015 si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Marja e këtij vendimi kaq haptazi të padrejtë cënon rëndë integritetin tim moral dhe profesional dhe gjithashtu dëmton rëndë interesat e Shoqërisë Shqiptare, sepse vjen si një presion apo shantazh i hapur mbi punën e anëtarëve të një nga Institucioneve më të Rëndësishme të Reformës në Drejtësi, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në këtë moment historik, i cili përkon me zgjedhjen e

prokurorëve të Prokurisë së Posaçme apo me zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm. Arsyet pse ky vendim është padrejtë dhe përmban të dhëna të rreme janë si më poshtë:

1. Unë kam deklaruar dhe rideklaroj nën përgjegjësinë time ligjore që nuk kam qënë asnjëherë në jetën time as bashkëpunorë dhe as anëtarë i Ish Sigurimit të Shtetit;
2. Të gjitha faktet e pasqyruara në pikën a) të dispozitivit të vendimit janë të rreme sepse nuk përputhen dukshëm me të dhënat e administruara nga AIDSSH. Në pjesën përshkuese të vendimit është e qartë që në të dhënat e gjetuara apo të administruara nga AIDSSH janë: *“Kartel model 2, nr.8023, me këto të dhëna, Bujar Rasim Shesha, datëlindja 1957, vendlindja Tiranë, arsimit dy të mesme, profesioni nxënës në shkollën e Mesme “Petro Nini Luarasi”, kategoria Inf, pseudonimi, Sektori V, drejtimi Inteligjencë Rini.* Gjeneralitet e mija nuk përputhem, në disa komponentë, me gjeneralitet e përshkruara në këtë dokument. Në vendim nuk ka asnjë shpjegim se si Autoriteti ka arritur në konkluzionin që personi i përshkruar në këtë dokument jam pikërisht unë Bujar Sheshi, për të cilin, Prokuroria e Përgjithshme kishte kërkuar informacion, në kushte kur gjeneralitet nuk përputhen dhe për më tepër kur nuk ka asnjë të dhënë tjetër në lidhje me aktivitetin e këtij personi. Asnjë nen i ligjit 45 të vitit 2015, nuk i ka dhënë të drejtë Autoritetit që të përshtasë të dhënat kryesisht dhe të nxjerrë konkluzione që këto të dhëna i përkasin një personi tjetër, me gjeneralite të ndryshme nga ato të përshkruara në dokumentat e administruara nga AIDSSH-ja.
3. Edhe konkluzioni i arritur në pikën b) të dispozitivit të vendimit, është i rremë, i ndryshëm nga të dhënat që pasqyrohen në pjesën përshkuese të vendimit si dhe në kundërshtim me ligjin 45/2015 si dhe ligjet e kohës, të cilat normonin mënyrën e funksionit të Hetuesisë. Në këtë pikë të vendimit thuhet që *“...figuron të ketë materiale në emër të tij, si anëtar, në dokumentat e sigurimit të shtetit, me detyrë hetues, në sektorin e Hetuesisë në Degën e Punëve të Brëndëshme të Fierit, që nga viti 1979”*. Jam emëruar në datë 12.07.1979, me detyrën e hetuesit në Degën e Punëve të Brëndëshme të Fierit dhe ky fakt është i pasqyruar qartësisht në jetëshkrimin tim apo në çdo dokument të tjetër që ka të bëjë me kandidimin për Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe jo vetëm. Në vitin 1974 bazuar në dekretin nr.5139 datë 30.01.1974¹, të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, hetusia është unifikuar dhe është përqëndruar pranë Ministrisë së Brëndëshme dhe vepron në bazë të rregullave të Kodit të Proçedurës Penale. Është e shprehur qartë në dekret dhe rrjedhimisht është e qartë edhe për çdo anëtarë të AIDSSH-së se mbas vitit 1974, Hetuesia dhe Organi i Sigurimit të Shtetit kanë qënë dy organe të ndryshme. Në këto kushte konkluzioni se bazuar në ligjin 45 të vitit 2015, ka të dhëna *“...figuron të ketë materiale në emër të tij, si anëtar, në dokumentat e sigurimit të shtetit.”* është i rremë dhe është shënuar në vendim, me qëllim cënimin e integritetit tim moral dhe profesional.

Në rastin konkret, veprimet e kundraligjshme nga Kryetaria e Komisionit apo edhe personat që kanë bashkëpunuar me të janë kryer me dashje, pra të dhënat e rreme janë shënuar me dashje në vendim me qëllim cënimin e integritetit tim moral dhe profesional. Ky konkluzion arrihet jo vetëm sepse të dhënat e përshkruara në pjesën e dispozitivit të vendimit, janë haptazi të pavërteta, por ky konkluzion (pra për elementët e anës subjektive) arrihet edhe nga analiza e disa shkelje të tjera ligjore të kryer nga anëtarët e Autoritetit, shkelje të cilat tregojnë qëllimin e kundraligjshëm në trajtimin e kërkesës së Drejtuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për kandidatit z.Bujar Sheshi. Më konkretisht:

¹ Miratuar me ligjin 5180 datë 19.06.1974.

1. Sipas përkufizimit që jepet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 45/2015, “*Bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit*” është çdo person që vërtetohet se ka bashkëpunuar në mënyrë të fshehtë me organet e ish-Sigurimit të Shtetit, në veprimtari të karakterit politik, që lidhen me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, “*Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë*”, të ndryshuar, për të cilët disponohen dosje, kartela ose regjistrime në indekset e kartotekave të ish-Sigurimit të Shtetit. Pra të quhesh bashkëpunëtor në kuptim të këtij ligji duhet të kesh dhënë informacione në mënyrë **aktive, për veprat penale të parashikuara në ligjin 7514 datë 30.09.1991**. Nëse ky kusht nuk plotësohet, nuk mund të quhesh bashkëpunëtor i ish sigurimit të shtetit, në kuptim të këtij ligji dhe për këtë arsye nuk mund të jepet informacion. Por pavarësisht këtij fakti, pra pavarësisht se nuk ka të dhëna që personi me gjeneralitet e përmendura në pjesën arsyetuese, te kete qënë aktiv, përsëri shënohet se ai është bashkëpunëtor.
2. Bazuar në ligjin 45 të vitit 2015 por edhe bazuar edhe në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar që ka si fokus mbrojtjen e të miturve, anëtarëve të AIDSSH, u ndalohe të japin të dhëna të administruara nga Autoriteti, kur këto të dhëna kanë të bëjnë me persona nën moshën 18 vjeç². Pra në emër të kujdo të jenë të dhënat, autoriteti nuk informon dhe nuk lëshon kopje të dokumenta kur këto të dhëna i përkasin një personi, nën 18 vjeç, siç të dhënat tregojë(bëhet fjalë për një person të lindur në vitin 1957, për të cilin kartela është hapur në 1974 dhe është arshivuar në vitin 1975); Por edhe këto kërkesa të ligjit nuk e detyrojnë Kryetaren e AIDSSH , të ndalet në paligjshmërinë e saj.
3. Bazuar në pikën 4 të nenit 29 të ligjit në fjale, Autoriteti **nuk administron kërkesat** për informacion për zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike kur ata kanë marrë certifikatën e pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “*Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare*”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “*Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik*” Pra është detyrë e komisionit të verifikojë në çdo rast përpara se të administrojë çfarë do lloj kërkesë për informacion, nëse jemi përpara këtij rasti apo jo. **Në vitin 1997 unë jam emëruar Drejtues i Prokurorisë së Tiranës, nga KLD dhe me sa jam në dijeni, Komisioni i ngitur në atë kohë ka kryer verifikimet edhe për mua dhe ka nxjerrë certifikatën e pastërtisë së figurës. Në këto kushte përpara se kërkesa duhet të admnistrohej duhet të verifikuar nëse për mua është lëshuar certifikata e pastërtisë së figurës.**
4. Përgjigja i është kthyer Prokurores së Përgjithshme, me shumë vonesë, pas tre muajëve. Nga faktet e përmendura në pjesën përshkruese të vendimit rezulton se nga data 31.10.2018 deri në datën 10.01.2019, pra rreth dy muaj e 10 ditë nuk është kryer asnjë veprim. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH-së, miratuar me vendimin 21 datë 09.05.2017 (neni 48) si dhe ligji 45/2015, detyrojnë punonjësit e këtij autoriteti, nën drejtimin dhe përgjegjësinë e Kryetares së këtij institucioni, që të veprojnë menjëherë në dhënien e informacionit të kërkuar apo kthimin e përgjigjes. Fakti që kërkesa është zvarritur kaq gjatë, në ndryshim nga raste të ngjashme, tregon tendencën dhe qëllimin e kundraligjshëm në rastin konkret.

² Shih nenin 21, 30 dhe 36 të ligjit.

Nga sa më sipër rezultojnë plotësisht elementët e anës objektive dhe subjektive të veprave penale të “ Falsifikimit të dokumentave” të kryer nga personi që ka për detyrë lëshimin e tyre si dhe veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal nga shtetësia Gentiana Sula me detyrë Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit(AIDSSH).

Burimet e provave ku bazohet kallëzimi im, si dhe provat që kërkojnë të merren në kuadër të hetimeve të këtij kallëzimi janë:

- Vendimi nr.12 datë 22.01.2019, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit(AIDSSH);
- Dekretin nr.5139 datë 30.01.1974³, të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, hetusia është unifikuar dhe është përqëndruar pranë Ministrisë së Brëndëshme;
- Të kqyret dhe të admnistrohet kopje e njësuar me origjinalin e *Kartelës model 2, nr.8023 që përmendet në vendim*
- Të sekuestrohet menjëherë, praktika e plotë që ka lidhje me trajtimin e kërkesës të dërguar pranë AIDSSH *me shkresën me nr.2373 datë 26.10.2018* të Prokurores së Përgjithshme, përfshi cdo relacion, procesverval, regjistrime audio apo video të mbledhjes ku është marrë vendimi në fjalë;
- Të sekeustrohet(kqyret) rregjistri elektronik
- Të kqyren librat e protokollit si dhe cdo akt i brëndëshëm i përpiluar në kuadër të trajtimit të kësaj kërkesë, të kyrera sipas parashikimeve të rregulles se AIDSSH
- Të merren prova të tjera të diktuar nga dinamika e hetimit

KALLËZUES
BUJAR SHESHI

³ Miratuar me ligjin 5180 datë 19.06.1974.